

Workshopi mbi Auditimet e Performancës ndërmjet audituesve të KLSH-së dhe ekspertëve të SAI-t të Norvegjisë

2 - 4 korrik 2024

Nga data 2-4 korrik 2024, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvillua workshop-i ndërmjet audituesve të Departamentit të Performancës në KLSH dhe 4 ekspertëve të SAI-t të Norvegjisë znj. Guri Andrea Lowrie, znj. Florina Zagragja, z. Bjørn Martin Ørvim, dhe z. Torkel Graham-Haga.

Në këtë workshop KLSH u përfaqësua nga disa auditues të ndarë sipas temave të auditimeve të performancës që po realizojnë e konkretisht:

1. Për temën e auditimit të performancës *“Cilësia e ujërave në plazhe”* morën pjesë anëtarët e grupit të auditimit: Aulemt Guri, përgjegjës i grupit të auditimit dhe Arminda Bushi, Eva Kushta, Vjola Kojani, anëtarë;
2. Për temën e auditimit të performancës *“Shërbimi Psiko-Social në sistemin arsimor para-universitar”* morën pjesë anëtarët e grupit të auditimit: Klarenc Xhaferaj, përgjegjës i grupit të auditimit dhe Megi Kurushi, Xhulieta Çelaj, Jorida Zhegu, Arjeta Çoku, Brisilda Hyka anëtarë;

Workshop-i u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit të KLSH-së dhe SAI-t të Norvegjisë, me qëllim mbështetjen e grupeve të auditimit në procesit e realizimit të auditimit të performancës në të gjitha fazat si në fazën e planifikimit të auditimit, studimore të auditimit, hartimit të programit, dizenjimit të tij, paraqitjes vizuale të të dhënave, e deri në shkrimin e raportit, kjo mbështetur në praktikën e SAI-t Norvegjez.



Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Alfred Zylfi, në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi përfaqësuesit e SAI-t të Norvegjisë për pjesëmarrjen në këtë workshop, dhe theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të proceseve të auditimit të performancës në KLSH. Gjithashtu takimi u përshëndet nga përfaqësuesit e SAI-t të Norvegjisë të

cilët në fjalën e tyre shprehën gatishmërinë për të mbështetur grupet e auditimit, referuar praktikave që ndiqen prej tyre në auditimet e performacës.

Workshop-i i cili zgjati 3 ditë, diskutoi tre elementë:

- Gjuha e qartë dhe e pastër e përdorur në auditimin e performancës;
- Vizualizimi i të dhënave në auditimet e performancës;
- Dhënia e rekomandimeve me cilësi të lartë.



Pas prezantimit të grupeve të auditimit dhe objektivit e qëllimit të auditimit nga secili grup workshopi vijoi me punën individuale të secilit grup auditimi sipas temave përkatëse.

1. Në auditimin me temë “*Shërbimi Psiko-Social në sistemin arsimor para-universitar*” ekspertët e SAI i Norvegjisë z. Torkel Graham-Haga dhe znj. Florina Zagragja të cilët do të ndjekin në vijimësi këtë auditimin, u njohën me punën e bërë deri më tani nëpërmjet një prezantimi të punës audituese të kryer deri në këtë fazë, bazën ligjore dhe rregullatore, institucionet përgjegjëse dhe rolin e tyre, risqet e identifikuar deri më tani në ofrimin e shërbimit psiko-social, të dhënat numerike të mbledhura gjatë kësaj periudhe, etj. Më tej, diskutimi midis përfaqësuesve u fokusua në fazat e auditimit, metodologjinë e nevojshme për mbledhjen e të dhënave, letrat e punës, etj., ku më hollësisht u trajtua

planifikimi dhe dizenjimi i fazës studimore, referuar praktikës së SAI-t të Norvegjisë.

Në vijim, u dakortësua që grupi i auditimit duhet të hartojë planin i cili paraprin fazën studimore, e që duhet të përmbajë:

- statusin aktual të shërbimit psiko-social në vendin tonë;
- autoritetet dhe rolin e tyre;
- të dhënat dhe metodologjinë për përpunimin e tyre;

Ky plan duhet të hartohet dhe t’i dërgohet homologëve të SAI-t Norvegjez brenda muajit korrik 2024. Më tej, do të vijohet me implementimin e tij.



2. Në auditimin me temë “*Cilësia e ujërave në plazhe*” ekspertët e SAI-t të Norvegjisë znj. Guri Andrea Lowrie dhe z. Bjørn Martin Ørvim, të cilët do të ndjekin në vijimësi këtë auditimi, u njohën me punën e bërë deri më tani, bazën ligjore dhe rregullatore, institucionet përgjegjëse dhe rolin e tyre, risqet e identifikuar deri më tani, mënyrën e organizimit të sistemit të menaxhimit dhe monitorimit të cilësisë së ujërave që derdhen në dete në vendin tonë, autoritetet dhe rolin e tyre, të dhënat dhe metodologjinë për përpunimin e tyre, etj. Diskutimi vijoi me fazat e auditimit,

metodologjinë e nevojshme për mbledhjen e të dhënave, letrat e punës, etj., ku më hollësisht u trajtua planifikimi dhe dizenjimi i fazës studimore, referuar praktikës së SAI-t të Norvegjisë. Grupi i auditimit duhet të hartojë planin studimor paraprak i cili paraprin fazën studimore, e që duhet të përmbajë:

- Fokusin e auditimit;
- Objektivat dhe çështjet nën auditim (shoqëruar me pyetjet audituese)
- Burimet e kritereve të auditimit;
- Informacion mbi grumbullimin e të dhënave;
- Organizimin dhe burimet;
- Kalendarin kohor;



Ky plan duhet të hartohet dhe t'i dërgohet homologëve të SAI-t Norvegjez brenda muajit Korrik 2024. Më tej, do të vijohet me implementimin e tij.

Në ditën e fundit të workshop-it të zhvilluar, përfaqësuesit e SAI-t Norvegjez, për të dy grupet e auditimit, bënë një prezantim mbi rëndësinë e shkrimit të rekomandimeve, kjo sa i përket qartësisë, nivelit të detajimit të tyre, ndjekjes së zbatimit, etj.

Gjithashtu, gjatë workshop-it u diskutua edhe kalendari kohor mbi ecurinë e këtyre dy auditimeve që po zhvillohen, i cili do të finalizohet pas dërgimit të sugjerimeve për të nga ekspertët.